



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE
SEKTORI I AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-SË

PROCESI I VETËVLERËSIMIT TË OFRUESVE PUBLIKË TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

RAPORT KOMBËTAR PËR PROCESIN DHE REZULTATET

PERIUDHA E VETËVLERËSIMIT

2019-2020

SHKURTIMET

AFP	Arsim dhe Formim Profesional
IoAFP	Institucion i ofruesit të Arsimit dhe Formimit Profesional
SD4E	Programi i Zhvillimit të Aftësive për Punësim
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
QA	Sigurimi i Cilësisë
SKPA	Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

KONTEKSTI HISTORIK

Sistemi i AFP-së në Shqipëri është një sistem kryesisht me bazë shkollën dhe me pjesëmarrje të ulët dhe të kufizuar të sektorit privat, në hartimin dhe ofrimin e programeve të arsimit. Në sistemin e AFP-së, AKAFPK ka zhvilluar një cikël koherent politikash të proceseve të brendshme për zhvillimin dhe ruajtjen e kualifikimeve profesionale,¹ i cili mbështet rëndësinë e kualifikimeve për tregun e punës. Në sfondin e politikave 10 vitet e fundit janë bërë përpjekje të shumta për ta zhvendosur fokusin drejt AFP-së dhe rezultatet kanë filluar të duken, ndër të cilat mund të përmendim aktivizimin për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe kuadrit të kualifikimeve, përmirësimin e procesit të të nxënës duke e vënë theksin te rëndësia e të nxënës me bazë punën, rritjen e ndjekjes së shkollave profesionale, promovimin e AFP-së përmes aktiviteteve promovionale dhe konkurruese etj. Një përpjekje e mirë është gjithashtu pjesëmarrja e biznesit në bordet e shkollave, me synim rritjen e kontributit të sektorit privat dhe pjesëmarrjen më aktive dhe më efikase të tij në AFP, duke plotësuar hendekun që ekziston mes arsimit profesional dhe tregut të punës, si dhe duke rritur cilësinë. Megjithatë, rritja e efikasitetit dhe cilësisë në AFP kërkon një kohë dhe angazhim më të madh për të plotësuar standardet e kërkuara.

¹ Udhëzuesi Metodologjik për Hartimin e Përshkrimeve të Kualifikimeve Profesionale në Shqipëri (2009), i disponueshëm online në: <http://www.akafp.gov.al/kualifikimet-profesionale/udhezues/>

Në këndvështrimin e përpjekjeve politike dhe teknike për përmirësimin e cilësisë në AFP, projekti i financuar nga qeveria zvicerane, “*Zhvillimi i aftësive për punësim*”, (SD4E) që po zbatohet nga UNDP në Shqipëri ka mbështetur qeverinë shqiptare në përpjekjet e saj për arritjen e objektivit të strategjisë kombëtare “*Vende pune cilësore dhe mundësi për aftësim për të gjitha gratë dhe burrat shqiptarë gjatë gjithë jetës*”², duke përmirësuar dhe rritur rezultatin e ofertës së AFP-së, duke krijuar në këtë mënyrë një terren me forcë punëtore të kualifikuar dhe mundësi më të mira punësimi për të rinjtë.

Në fazën e implementimit të projektit, UNDP Shqipëri në kuadër të standardizimit të sigurimit të cilësisë ka kontribuar në përmirësimin e imazhit të AFP-së dhe harmonizimin e afrimit të AFP-së me tregun e punës. Ndërhyrjet në kuadër të rezultatis 3 të projektit SD4E janë projektuar në përputhje me prioritetin 2 të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe në koordinimin dhe bashkëpunimin e ngushtë me MFE-në dhe AKAFPK-në. Një nga produktet është sigurimi i cilësisë së kualifikimeve profesionale sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me një model tashmë të konsoliduar për akreditimin e ofruesve të AFP-së.

Projekti SD4E, në bashkëpunim të ngushtë me AKAFPK dhe grupe të tjera interesi, ka punuar për të përcaktuar tiparet e dëshiruara dhe fizibilitetin e sistemit të sigurimit të cilësisë. Zhvillimi dhe pilotimi i instrumentit të vetëvlerësimit në fazën e mëparshme të projektit SD4E ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit për të krijuar një kuptim të përbashkët lidhur me standardet e dëshiruara. Një grup kriteresh dhe standardesh minimale të pranueshme, pjesë e instrumentit të vetëvlerësimit, janë zbatuar nga të gjithë ofruesit publikë të AFP-së në Shqipëri. Këto standarde dhe kriteret, krijuan bazën për modelin e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit në AFP drejt modernizimit të kontekstit të arsimit profesional dhe garancisë që të diplomuarit e AFP-së, të kenë njohuritë dhe kualifikimet për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës.

Praktikat e mira dhe përvojat bashkëkohore tregojnë se për të arritur cilësinë në AFP, institucionet që ofrojnë arsim dhe formim profesional, mund të fillojnë duke kryer vetëvlerësimin objektiv të tyre dhe identifikimin e pikave të tyre të forta dhe të fushave problematike. Zbatimi i vetëvlerësimit nga 44 ofrues publikë të AFP-së evidenton se ata mund të identifikojnë disa aspekte pozitive, si dhe fusha problematike, në të pesta fushat e cilësisë. Rezultatet e vetëvlerësimit do të konsiderohen me seriozitet nga secili prej tyre dhe do të shërbejnë për përmirësimin e atyre fushave problematike në periudhën e ardhshme. Në kuadër të projektit është zhvilluar modeli i akreditimit për institucionet e AFP-së, ku fushat e cilësisë të vlerësuara gjatë vetëvlerësimit do të krahasohen nga një proces i jashtëm vlerësimi.

Pra, procesi i vetëvlerësimit dhe rezultatet e tij mund të konsiderohen të suksesshme kur përputhen në shumicën e dimensioneve të cilësisë me rezultatet e një procesi vlerësimi të jashtëm.

² National Strategy for Vocational Education Training and Lifelong Learning (2013-2020) https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/m/2F2ABAD2B5A1126EC1257B650030CA17_TRP%202012%20Albania_EN.pdf

Kuadri rregullator për vetëvletësimin (Qa) në sistemin e AFP-së në Shqipëri

Kuadri strategjik

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2022 ka si objektiv të përgjithshëm promovimin e punëve cilësore dhe të mundësive për aftësi për të gjitha gratë dhe burrat shqiptarë gjatë gjithë jetës; ky objektiv do të ndiqet me një sërë masash plotësuese dhe të ndërlidhura që njëkohësisht mbështesin ofertën e punës, nxisin kërkesën për punë dhe trajtojnë përjashtimin e thellë social. Strategjia është e përqëndruar në katër shtylla ose linja masash që programi synon të arrijë. Një nga katër prioritetet strategjike (shtylla B) e SKPA 2014-2022 fokusohet në “ofrimin e arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit”, duke e vënë theksin te masat që synojnë përmirësimin e cilësisë së ofrimit në nivelin e ofruesve.

Kuadri ligjor

Ligji nr. 15/2017, datë 16.2.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional”, kreu V “Sigurimi i Cilësisë” përcakton bazën për zhvillimin e një kuadri të sigurimit të cilësisë në sistemin shqiptar të AFP-së, duke përfshirë licencimin, vetëvlerësimin, inspektimin dhe akreditimin.

Ligji nr. 10247, datë 4.3.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” (KSHK), i ndryshuar dhe i përmirësuar në vitin 2018 (Ligji nr. 23/2018, datë 10.5.2018), përshkruan veçoritë kryesore të KSHK-së, si strukturën, fushën e veprimit, objektivat dhe funksionet, si dhe masat për qeverisjen, menaxhimin institucional, sigurimin e cilësisë dhe financimin. Fokusi kryesor i parashikuar nga ligji, ndër shumë të tjera, thekson çështjen e sigurimit të cilësisë në AFP. Kjo do të thotë që të gjitha institucionet e arsimit dhe formimit profesional duhet të plotësojnë standarde të caktuara të cilësisë përsa i përket burimeve njerëzore dhe fizike, sistemeve dhe procedurave, menaxhimit, procesit të të nxënies etj. Sigurimi i cilësisë duhet të jetë guri i themelit i çdo institucioni që ofron arsim dhe formim profesional dhe një aspekt shumë i rëndësishëm për përmirësimin e imazhit të AFP-së dhe prodhimin e një force punëtore të kualifikuar për tregun e punës.

Për më tepër, kuadri ligjor për arsimin parauniversitar (Ligji nr. 69/2012 dhe legjislacioni dytësor përkatës) parashikon rregullat dhe kriteret për kuadrin e zhvillimit institucional dhe të cilësisë, veçanërisht për ofruesit e AFP-së që ofrojnë programe të arsimit të mesëm të lartë³. Janë përcaktuar procedura dhe kriteret të qarta lidhur me: 1) planin strategjik afatmesëm (4 vjeçar); 2) planin vjetor të punës dhe 3) fushën e veprimit, zbatimin dhe përdorimin e vetëvlerësimit të institucioneve parauniversitare, duke përfshirë shkollat e AFP-së.

Së fundi, *Udhëzimi i Ministrit nr.16, datë 8 maj 2018*, i cili miraton Udhëzuesin Zyrtar për vetëvlerësimin dhe përcakton përgjegjësitë e ofruesve dhe institucioneve në nivelin qendror, si

³ Akti më i rëndësishëm nënligjor për funksionimin e arsimit parauniversitar është e ashtuquajtura “Dispozita Normative”, e cila është një rregullore gjithëpërfshirëse që mbulon të gjitha aspektet e arsimit bazë dhe të mesëm duke përfshirë edhe AFP-në.

dhe Udhëzimi i Ministrit nr. 16/1, datë 16 tetor 2018, i ndryshuar, përcaktojnë arritjen e parë kyçe për një zbatim gjithëpërfshirës të kuadrit të sigurimit të cilësisë, duke përfshirë shkollat e AFP-së, qendrat e formimit profesional dhe të gjithë ofruesit publikë të AFP-së.

Kuadri institucional për sigurimin e cilësisë në AFP

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në cilësinë e institucionit më të lartë përgjegjës për politikat e AFP-së, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i është besuar me ligj detyra e krijimit të kuadrit të sigurimit të cilësisë në sistemin e AFP-së, duke përfshirë të gjithë komponentët e këtij sistemi, siç janë licencimi, hapja dhe mbyllja e ofruesve publikë të AFP-së, si dhe miratimi i legjislacionit dytësor për akreditimin, vetëvlerësimin, monitorimin dhe inspektimin. Më konkretisht, Ministria është përgjegjëse për zhvillimin e bazës ligjore, garantimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare dhe sigurimin e infrastrukturës. Në sektorin publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për miratimin e hapjes, organizimit dhe mbylljes së ofruesve publikë të AFP-së mbi bazën e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Ajo miraton ofrimin e programeve të AFP-së në bazë të kualifikimeve kombëtare të ofruara nga ofruesit publikë të AFP-së dhe miraton modelin, standardet dhe kriteret e akreditimit të propozuara nga AKAFPK. Ministria bashkëpunon ngushtë me Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe jep miratimin fillestar përse i përket licencimit të ofruesve privatë të AFP-së. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i takon gjithashtu një nga funksionet kyçe të sigurimit të cilësisë, i cili është inspektimi.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)

AKAFPK është institucioni përgjegjës për krijimin e një sistemi të unifikuar të kualifikimeve profesionale të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, një sistem që u mundëson pjesëmarrësve (nxënësve) të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca për të përballuar sfidat e zhvillimit social-ekonomik të vendit. AKAFPK mbështet ministrinë përgjegjëse për të forcuar dimensionin evropian të sistemit shqiptar të kualifikimeve. Në sektorin e AFP-së, AKAFPK ka përgjegjësi dhe kompetencë të plotë për të ushtruar funksionet kryesore të KSHK-së. Ndër detyrat e tjera dhe në lidhje me zbatimin e ligjit për KSHK-në, AKAFPK kryen vlerësimet e kualifikimeve dhe i krahason ato me kualifikimet ndërkombëtare, si dhe propozon ndryshime në kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve të përfshira në KSHK etj.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)

Bazuar në nenin 9 të ligjit për AFP-në, AKPA është përgjegjëse për menaxhimin e rrjetit të ofruesve publikë të AFP-së. Me këtë detyrë, AKPA do të jetë përgjegjëse për monitorimin e veprimtarisë së përditshme të ofruesve të AFP-së. Krahas kësaj, AKPA-së i është besuar detyra e mirëmbajtjes dhe përditësimit të regjistrit kombëtar të certifikatave, si dhe detyra e gjurmimit të nxënësve të AFP-së pas diplomimit.

Instrumenti dhe Metodologjia e Vetëvlerësimit

Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit nga ofruesit publikë të AFP-së kërkon përdorimin e një metodologjie të qartë, të besueshme dhe shkencore, e cila siguron informacion dhe të dhëna që pasqyrojnë pikat e forta, pikat e dobëta dhe mundësitë në kualifikimet profesionale të ofruara nga ofruesit e AFP-së, por thekson nevojën për përmirësime në të ardhmen.

Përhapja e kulturës së vetëvlerësimit është një qasje profesionale dhe sfiduese që kërkon njohjen dhe zotërimin e standardeve profesionale dhe etike të vlerësimit, si edhe përkushtim dhe përgjegjshmëri nga të gjithë personat e përfshirë në vlerësim si mësuesit, nxënësit/kursantët, ekipet e vlerësimit, por edhe nga autoritetet dhe organet drejtuese të ofruesit të AFP-së.

Elementët e metodologjisë së vetëvlerësimit në AFP përfshijnë 5 dimensionet e cilësisë së veprimtarisë së ofruesve të AFP-së. Instrumenti i vetëvlerësimit i hartuar me mbështetjen e programit SD4E shërbeu për të udhëhequr zbatimin e procesit të vetëvlerësimit dhe shpjegon në mënyrë të hollësishme të gjitha fushat, duke përfshirë nënfushat e secilës fushë. Ai përfshin përshkrimet e fushave, nënfushave, kriterëve, niveleve të vlerësimit dhe standardeve.

Fusha nënkupton një dimension themelor të veprimtarisë së ofruesit të AFP-së dhe lidhet drejtpërdrejt me të gjithë veprimtarinë e tij. Përcaktimi i fushave të veprimtarisë bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore për arsimin profesional dhe arsimin e përgjithshëm. Janë përcaktuar këto fusha kryesore të vetëvlerësimit:

- I. Menaxhimi dhe drejtimi
- II. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi
- III. Kurrikula e zbatuar
- IV. Mësimdhënia dhe të nxënit
- V. Vlerësimi

Nënfusha është një nën-ndarje me detaje dhe elemente që tregon dhe plotëson më së miri përmbajtjen e një fushe të caktuar në të cilën punon ofruesi i AFP-së. Për shembull, nëse njëra nga fushat është “*Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi*”, nënfushat janë “*Marrëdhëniet me komunitetin dhe shoqërinë civile*”, “*Marrëdhëniet me biznesin*” etj.

Këto nënfusha synojnë të identifikojnë se çfarë marrëdhëniesh dhe çfarë forma bashkëpunimi ka institucioni i AFP-së me partnerët e tij. Ato konsiderohen si një mundësi për të identifikuar, për të vëzhguar dhe për të vlerësuar në imtësi atë që ndodh brenda ofruesit të AFP-së. Pra nënfushat kryejnë dy funksione:

- zbërthejnë fushën në elementë organike të domosdoshme për të;
- mundësojnë njohjen dhe vlerësimin real të situatës brenda ofruesit të AFP-së.

Treguesi është një fjali e matshme pohuese që tregon se si është dhe si duhet të jetë fusha. Përmes treguesve, ne vlerësojmë se si është vetëvlerësuar ofruesi i AFP-së.

Karakteristikat e treguesve

- hartohen për secilën nënfushë dhe mund të jenë një ose disa të tillë;
- janë gjithnjë të matshëm, gjë që do të thotë se ata lehtësojnë procesin e vetëvlerësimit;
- paraqesin pohime që specifikojnë fushën që do të vlerësohet.

Kriteri është një nën-ndarje e treguesve. Shprehet në formën e një fjalie që përcakton si është zbatuar, si është organizuar apo në ç'gjendje paraqitet treguesi. Ai sugjeron mbledhjen e informacioneve dhe mundëson arritjen e treguesve nga institucioni i AFP-së.

Nivelet e vlerësimit janë nivelet e përdorura për vlerësimin e institucionit të AFP-së nëpërmjet fushave të tij. Vlerësimi kryhet për çdo kriter të secilit tregues të një fushe. Nivelet e vlerësimit janë katër: shumë mirë, që përkon me numrin 1; mirë, që përkon me numrin 2; mjaftueshëm, që përkon me numrin 3; dhe dobët, që përkon me numrin 4. Skema me katër nivele vlerësimi është mjaft e përdorur në vlerësimin e ofruesve të AFP-së në vendet e Evropës. Po ashtu, ky sistem me katër nivele mundëson një vlerësim real dhe përfshin të gjitha nivelet që mund të arrijnë institucionet e AFP-së sipas treguesve.

Standardi është përshkrimi i situatës së ofruesit të AFP-së për secilën fushë, i cili mundëson një vlerësim sipas niveleve të mësipërme të vlerësimit. Ky vlerësim është rezultat i përpunimit të të dhënave të instrumenteve të monitorimit dhe vlerësimit të siguruara për secilin tregues dhe kriter, por edhe i të dhënave të siguruara nga metodologjia e zbatuar gjatë vlerësimit të brendshëm. Vlerësimi përfundimtar për një fushë specifike bazohet gjithmonë në peshën dhe rëndësinë e zbatimit të secilit tregues dhe kriter në situatën e ofruesit të AFP-së.

Tabela1: Ilustrimi i instrumentit të vetëvlerësimit, duke përfshirë fushat, nënfushat dhe treguesit

Nr	Fusha	Nënfusha	Treguesit
I	“Menaxhimi dhe drejtimi”	Vlerësimi i brendshëm (vetëvlerësimi)	Ofruesi i AFP-së realizon vetëvlerësimin
II	“Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi”	Marrëdhënia dhe bashkëpunimi me bizneset”	Ofruesi i AFP-së komunikon me bizneset nëpërmjet koordinatorit me biznesin (dikur i njohur si PASO)
III	“Kurrikula e zbatuar	Kurrikula me bazë shkollën	Programet/kurset profesionale të unifikuara zhvillohen konform kërkesave të dokumenteve zyrtare
IV	“Mësimdhënia dhe të nxëniti”	Plani i zhvillimit të moduleve mësimore të praktikës profesionale	Mësuesi/instruktori harton planet e zhvillimit të moduleve të praktikës profesionale në përputhje me dokumentet kurrikulare dhe sipas veçorive të nxënësve
V	“Vlerësimi”	Vlerësimi i njohurive	Mësuesi/instruktori ka një program/plan të qartë për vlerësimin e nxënësve

Vetëvlerësimi

Përgatitja dhe zbatimi

Faza e parë: Tetor –Dhjetor 2020

Në zbatim të “Udhëzimit të Ministrit nr.16, datë 8.5.2018” (të ndryshuar), ekipi përgjegjës i AKAFPK-së dhe projekti SD4E, hartuan planin shoqërues për të ndihmuar ofruesit e AFP-së në këtë përpjekje gjithëpërfshirëse për të vlerësuar të gjitha dimensionet e cilësisë brenda institucioneve të tyre. Mbështetja konsistonte në organizimin e vizitave dhe të diskutimeve të dedikuara me çdo ofrues të AFP-së, me qëllim prezantimin dhe dakordësimin e planeve të zbatimit. Ata u udhëzuan të ndjekin planin e përgjithshëm, të cilësuar nga Urdhri i Ministrit si në tabelën e mëposhtme.

Plani i zbatimit të vetëvlerësimit në institucionet publike dhe jo publike ofruese të AFP-së

Nr.	Masat	Afati	Personat përgjegjës
1	Krijimi i ekipit qendror të vetëvlerësimit	25 janar 2021	Drejtori i ofruesit të AFP-së
2	Miratimi i ekipit të vetëvlerësimit	27 janar 2021	Këshilli i mësuesve
3	Hartimi i planit të vetëvlerësimit për fushat e përzgjedhura	17 shkurt 2021	Ekipi i vetëvlerësimit
4	Miratimi i planit të vetëvlerësimit nga drejtori	25 shkurt 2021	Drejtori i ofruesit të AFP-së
5	Mbështetje dhe trajnim në përdorimin e platformës digjitale për procesin e vetë-vlerësimit të ofruesve të AFP-ve.	20 janar-25 Shkurt 2021	Specialistë të AKAFPK
6	Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit me platformën digjitale (plotësimi i platformës, plotësimi i pyetësorëve, vëzhgime, mbledhje informacioni etj.) për fushat e përzgjedhura nga institucioni	1 mars 2021	Ekipi i vetëvlerësimit; drejtori, bordi, mësuesit, nxënësit/kursantët, bizneset
7	Hedhja e të dhënave dhe gjetjeve/evidencave në platformën digjitale, për të gjitha kriteret, për fushën/fushat e përzgjedhura	16 prill 2021	Ekipi i vetëvlerësimit
8	Përgatitja e raportit të vetëvlerësimit për fushat e përzgjedhura nga institucioni, sipas modelit në platformën digjitale.	30 prill 2021	Ekipi i vetëvlerësimit

9	Monitorimi dhe mbështetja e procesit të vetëvlerësimit nga specialistë të AKAFPK	Mars- maj 2021	Specialistë të AKAFPK
10	Miratimi i raportit të vetëvlerësimit nga bordi/këshilli i mësuesve	14 maj 2021	Bordi, këshilli i mësuesve, drejtori i ofruesit të AFP-së
11	Hedhja e raportit final të vetëvlerësimit në platformën digjitale	21 maj 2021	Drejtori i ofruesit të AFP-së

Faza e dytë: Janar- Mars 2021

Kjo fazë u konsiderua si monitorim-mbështetje afatmesme për të vlerësuar progresin e vetëvlerësimit nga secili ofrues i AFP-së dhe për të parë se cilat janë shqetësimet dhe pasiguritë e tyre. Veçanërisht lidhur me kuptimin e perceptimit rreth treguesve, kriterëve dhe provave, që ata duhej të përdornin për vlerësimin e fushave ose nënfushave specifike. Këto vizita ishin të domosdoshme sepse shërbyen për të sqaruar çështje të lidhura me qartësimin e kriterëve të caktuara nga i gjithë instrumenti, të cilat nuk ishin shumë të qarta për të gjitha ekipet e vetëvlerësimit, duke qenë se kjo ishte hera e parë që kryhej një vetëvlerësim i brendshëm nga një ekip i institucionit të AFP-së. Gjatë vizitave monitoruese, çështjet e lidhura me treguesit përkundrejt kriterëve, të cilat gjykojnë nivelin e arritjes së një treguesi të synuar u shpjeguan individualisht me secilin ofrues të AFP-së. Gjithashtu, në ato vizita u diskutuan nivelet e vlerësimit dhe standardet që duhet të përmbushin institucionet e AFP-së në secilën prej fushave që do të vlerësonin.

Faza e tretë: Mars-Maj 2021

Gjatë zbatimit të fazës së dytë të monitorimit dhe mbështetjes së zbatimit të vetëvlerësimit nga ofruesit e AFP-së, u vu re se nevojitej një mbështetje më e ngushtë për ta. Ofruesit e AFP-së u mbështetën me kontrollin e të gjithë dokumentacionit për procesin e vlerësimit dhe për mbledhjen dhe përpunimin e rezultateve.

REZULTATET E PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT 2019-2020

Procesi i vetëvlerësimit u finalizua nga 44 ofrues të AFP-së të cilët i dorëzuan raportet. Rezultatet e raporteve u përpunuan dhe u përmbledhën nga specialistët e AKAFPK-së në sektorin e akreditimit të Ofruesve të AFP-së, të cilët analizuan të dhënat sasiore dhe cilësore nga raportet e vetëvlerësimit. AKAFPK-ja ka mbajtur një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me secilin nga 44 ofruesit e AFP-ve, ku secilit prej ofruesve i është komunikuar progresi i arritur si dhe është diskutuar për të metat apo mangësitë që kanë patur.

Raporti do të marrë në konsideratë në mënyrë tepër të përmbledhur të gjitha nënfushat e të *pestë* fushave kryesore që përdor instrumenti i brendshëm i *vetëvlerësimit* për të matur ecurinë e cilësisë të ofruesit të AFP-së. Çdo nënfushë do të ndahet në dy pjesë ku në pjesën e parë do të renditet rezultati që është arritur kurse në pjesën e dytë do të vihet në dukje dobësitë që janë hasur. Raport do të jetë publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë ofruesit e AFP-ve.

Në përmbledhjen e raportit, janë theksuan aspektet pozitive dhe fushat që duhen përmirësuar në të ardhmen.

FUSHA 1 – Menaxhimi Dhe Organizimi

Në vetvete kjo fushë përbën rëndësinë e saj nga vetë emërimi që ka “*Menaxhimi dhe Organizimi*”, është lehtësisht e kuptueshme që nëse nuk ka një menaxhim të mirë dhe një organizim të mirë rezultati final dihet që do të jetë dështim në kuptimin literal të fjalës.

“*Menaxhimi dhe Organizimi*” është i një rëndësie të veçantë sepse në këtë fushë do të dëshmohet sesa ofruesit e AFP-ve kanë përcaktuar qartë planet, vlerësimet, burimet njerëzore, efektivitetin e përdorimit të të gjitha llojeve të kapitaleve që zotëron si dhe sesa gjithëpërfshirëse është në tërësinë e saj ofruesi i AFP-së.

Ka qënë 10 numri i ofruesve të AFP-ve në rang kombëtar të cilat kanë kryer vetëvlerësimin në fushën e parë në “*Menaxhimi dhe Organizimi*”.

Vetë fusha 1 “*Menaxhimi dhe Organizimi*” është i përbërë në nëntë nënfusha të cilat së bashku kontribuojnë në përmbushjen e saj, këto nënfusha janë:

1. Gjithëpërfshirja;
2. Plani afatmesëm i ofruesve të AFP-së;
3. Plani vjetor i institucioneve ofruese të AFP-së;
4. Plani i vëzhgimit në klasë;
5. Plani i monitorimit të dokumentacionit institucional
6. Statistikat e ofruesve të AFP-së, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve;
7. Vetëvlerësimi/vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së
8. Zhvillimi profesional i stafit;
9. Efektiviteti i burimeve njerëzore dhe financiare

1. Gjithëpërfshirja;

a. Rezultati

Vihet re një ndryshim pozitiv nga të gjitha ofruesit e AFP-ve të cilat kanë qënë të hapura dhe kanë përfshirë një pjesë të konsiderueshme të stafit të tyre duke i ngarkuar me detyra specifike nëpër strukturat që vetë ofruesit e AFP-ve kanë ngritur në përmbushjen e *Udhëzimit nr. 16/2018 (të ndryshuar)*.

Është e materializuar përfshirja e stafit edhe në raportet vjetore të vetëvlerësimit, ku renditen të gjithë kontribuesit e realizimit të procesit të vetëvlerësimit.

Tashmë është evidentë që të gjitha ofruesit e AFP-ve kanë krijuar strukturat e brendshme si: *Bordi Drejtues; Këshilli i Mësueseve; Qeveria e Nxënësve; Këshilli i Prindërve të ofruesve të AFP-së; Këshilli i Prindërve të Klasës; Komisioni i Disiplinës; Komisioni i Etikës dhe Sjelljes.* Të gjithë strukturat e sipërpërmendura janë krijuar konform kërkesave ligjore si dhe funksionojnë dhe ndërveprojnë mes tyre në përmbushje të qëllimit të krijuar.

b. Dobësitë

Ka një vështirësi në përfshirjen e prindërve në strukturat e këshillave të prindërve. Kjo vështirësi vjen kryesisht për shkak se prindërit janë në marrëdhënie pune, kanë një distancë fizike të largët me ofruesin e AFP-së, mungesa e formim-edukimit të prindërve, pamundësi të ndryshme. Kërkohej një përfshire edhe më e gjërë e bordeve të ofruesve të AFP-ve.

2. *Plani afatmesëm i ofruesve të AFP-së;*

a. Rezultati

Plani afatmesëm përfshihet nga ofruesit e AFP-ve dhe ndiqet me rregullsi, të gjithë ofruesit e AFP-ve bazojnë veprimtarinë e tyre në planin afat mesëm i cili është një busull për vazhdimësinë e procesit mësimor.

b. Dobësitë

Në përgjithësi ofruesit e AFP-ve nuk shfaqin dobësi në plani afatmesëm.

3. *Plani vjetor i institucioneve ofruese të AFP-së;*

a. Rezultati

Në të njëjtën linjë edhe plani vjetor si një detajim i mëtejshëm i planit afatmesëm është prioritarë për ofruesit e AFP-ve. Shohim një impenjim dhe një përfshirje më të madhe në planin vjetor ku të gjitha struktura e ofruesive të AFP-ve realizojnë inputet e tyre sipas përshkrimit të *Udhëzimit 18 datë 6.7.2018 (i ndryshuar).*

b. Dobësitë

Në përgjithësi ofruesit e AFP-ve nuk shfaqin dobësi në plani vjetor, drejtorja, njësia e zhvillimit i ka të përgatitura *planet vjetore* konform rregullave.

4. *Plani i vëzhgimit në klasë;*

a. Rezultati

Plani i vëzhgimit ka ecur në sipas planifikimet të bëra dhe ka kontribuar në identifikimin e situatave të cilat do të duhet të përmirësohen. Drejtoritë e zbatojnë planin e vëzhgimit si dhe e ndjekin përgjatë gjithë kohës. Të dhënat e vëzhgimeve përdoren për të bërë vlerësimin e performancës.

b. Dobësitë

Duhet të forcim më i mirë i një bashkëpunim mes mësuesit dhe ekipit kurrikular.

5. *Plani i monitorimit të dokumentacionit institucional*

a. Rezultati

Ofruesit e AFP-ve e realizojnë plotësimin e kësaj nënfushe dhe veprojnë në përputhje me detyrat që aktet nënligjore ju kanë ngarkuar duke filluar që nga planifikimi i vëzhgimit të dokumentacionit më pas me planet lëndore, modulet, regjistrat, amza, dëftesat, certifikatat, dëshmitë, librave të inventarëve të ndryshme deri në zhdëmtimet e pajisjeve.

b. Dobësitë

Janë hasur disa parregullsi në lidhje me Regjistrat por më pas janë diskutuar për marrjen e masave të nevojshme në përputhje me rregullat.

6. *Statistikat e ofruesve të AFP-së, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve;*

a. Rezultati

Kjo nënfushë vlen të theksohet se nëpërgjithësi ka një rregullsi të plotë nga ofruesit e AFP-ve dhe zbatohet rregullisht pre tyre. Ofruesit e AFP-ve regjistrimin e nxënësit, respektimin e kriterëve të moshës, ruajtjen e dokumentave, zbatimin e procedurave për transferim etj, e kryejnë sipas legjislationit.

b. Dobësitë

Nuk janë vërejtur dobësi në këtë nënfushë.

7. *Vetëvlerësimi/vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së*

a. Rezultati

Ka një zhvillim pozitiv plotësimi i kësaj nënfushe krahasuar më vitin e mëparshëm, sepse të gjitha strukturat e ofruesve të AFP-së janë vënë në lëvizje për të përmbushur këtë detyrim, ka një ndërveprim progresiv mes ekipeve për shkak se stafet mësimore përfshihen në këtë proces.

b. Dobësitë

Gjithësesi, mbetet ende për të patur përmirësim në këtë nënfushë e cila lidhet me vetë procesin e vetëvlerësimit në tërësi. Raporti përfundimtar i vetëvlerësimit që ofruesit e AFP-ve përpunojnë duhet të jenë më të qarta, të adresojnë më cilësisht arritjet dhe sfidat që hasin, të raportojnë më në detaje problemet, raporte duhet të jenë më koncize, më të kuptueshme më të strukturuar dhe realiste duke ju dhënë përgjigje më specifike të gjitha kërkesave të Udhëzimit 16/2018 (të ndryshuar). Ka mungesë të kapaciteteve të njësive të zhvillimit për të prodhuar raporte cilësore.

8. Zhvillimi profesional i stafit;

a. Rezultati

Nga vetë ndërveprimi dhe gjithëpërfshirja e stafi të ofruesve të AFP-ve, komunikimi mes tyre mbetet pozitiv dhe në tërësi ka sjellë që edhe zhvillimi profesional i stafit të adresohet në mënyrën e duhur dhe të saktë. Ofruesit e AFP-së bënë identifikimin e nevojave për trajnim të stafit në harmoni me kërkesat që vijnë nga vetë stafi, përcakton grupe mësuesish/instruktorësh për trajnim, mbështet mësuesit që i nënshtrohen një fitimi të një shkalle më lart, kanë plan punë për shkëmbimin e përvojave profesionale.

b. Dobësitë

Duhet një përfshirje më të madhe për trajnimin e *instruktorëve*, apo edhe trajnime në lidhje me *gjuhën angleze* çka do të janë mundësinë për përfshirjen në bashkëpunim më të madh me aktorë të tjerë.

9. Efektiviteti i burimeve njerëzore dhe financiare

a. Rezultati

Ofruesit e AFP-ve për shkak të përvojës që kanë akumuluar dhe trajnimeve të ndryshme që kanë marrë nga aktorë të ndryshëm, kanë arritur të kuptojnë qartë përgjegjësinë që kanë për të përdorur burimet me efektivitet dhe në përgjithësi shohim një përkushtim dhe impenjim nga stafet e ofruesve të AFP-ve.


Ofruesit e AFP-së identifikon çdo vit nevojat e tij, rekruton staf mësimor dhe mbështetës, menaxhon mirë mungesat e stafit, ndan në mënyrë të qartë detyrat dhe përgjegjësit e personelit, mundëson bashkëpunimin midis stafit mësimor me stafin mbështetës, shpenzon buxhetin sipas planit, si dhe shpenzimet janë të dokumentuar sipas ligjit.

b. Dobësi


Nuk kanë hasur ndonjë vështirësi apo dobësi në përmbushjen e kësaj nënfushe.

Paraqitja Grafike:

Në formë grafike rezultati i fushës së parë për 10 ofuresit e AFP-së do të paraqitej si më poshtë⁴.




Në formë grafike rezultati i **nënfushave** të Fushës “Menaxhimi dhe drejtimi” do të paraqitej si më poshtë:



Nga analiza e 10 ofruesve të AFP-së të cilët kanë plotësuar fushën 1 “Menaxhimi dhe Drejtimi” ka rezultuar se 4 prej tyre e shohin veten **shumë të mirë** në këtë fushë, 6 prej tyre e shohin veten të **mirë**, ndërkohë që nuk ka asnjë ofrues që e ka vlerësuar veten mjaftueshëm apo dobët. Të dhënat janë paraqitur në figurën e mëposhtme:

⁴ Vlera numerike 1 është shumë mire, kurse vlera numerike 4 është shumë dobët



FUSHA 2 – Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi

Dimensioni i dytë i vetëvlerësimit është “*Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi*” i cili në vetvete ka qëllimin për të treguar dhe për të nxjerr në pah sesa bashkëpunues, ndëraktiv dhe dinamik është ofruesi i AFP-së, sepse pikërisht në bazë të dinamikës të ndërveprimit që ofruesi i AFP-së zhvillon do të përcaktohet suksesi dhe arritja e qëllimeve që ka në vetvete ofruesi i AFP-së. Ofruesi i AFP-së ka një hapësirë të gjërë për të përdorur çdo lloj forme bashkëpunimi gjithmonë me qëllimin të forcimit dhe rritjes së profesionalizimit të vetë ofruesit të AFP-së duke rritur besueshmërinë dhe konkurueshmërinë në treg.

Janë 15 ofrues të AFP-ve të cilat kanë kryer vetëvlerësimin në fushën e dytë në “*Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi*”.

Nënfushat që tregojnë nëse ky dimension është realizuar siç duhet janë katër, si më poshtë:

1. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore.
2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin.
3. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe komunitetin
4. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vet ofruesve të AFP-së dhe institucioneve.

1. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore

a. Rezultati

Në këtë fushë shohim një rritje të bashkëpunimit midis ofruesit të AFP-ve dhe organeve qeveritare si dhe ka një zhvillim pozitiv në këtë drejtim. Ofruesi i AFP-së përcjell konform rregullave ligjore dokumentacionet zyrtare, zbaton urdhërimet zyrtare, informon institucionet zyrtare për ecurinë e saj, merr pjesë në aktivitetet që zhvillojnë institucionet zyrtarë në nivel rajoni, kombëtar apo ndërkombëtar. Ofruesit e AFP-ve gjithmonë kërkojnë mbështetje nga institucionet zyrtare, dërgon raportet sipas kërkesave të vetë institucioneve zyrtare, bashkëpunon

më qeverisjen vendore në lidhje me bursat, apo për nxënësit me nevoja të veçanta, apo vështirësi të theksuara sociale. Ofruesi i AFP-së bashkëpunon dhe zhvillon veprimtari bashkëpunimi me aspekte gjinore me institucionet zyrtare.

b. Dobësitë

Pushteti lokal jo gjithmonë i mbështet me fonde apo të plotësojë kërkesat që ofruesit e AFP-ve dërgojnë, kjo edhe për shkak të kufizimeve buxhetore që këto institucione kanë.

2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin

a. Rezultati

Shihet që në disa rajone po rritet bashkëpunimi me ofruesit e AFP-ve, kjo për shkak të punës që vetë Ofruesit e AFP-ve kanë zhvilluar ndër vite, por edhe për shkak të profileve që vetë ofruesit e AFP-ve ofrojnë për të cilat biznesi ka nevoje (*kryesisht për staf të ri*). Vihet re që ofruesit e AFP-ve kanë arritur edhe të kryejnë kontrata bashkëpunimi si dhe të zhvillojnë rregullisht praktika mësimore nëpër ambientet e biznesit, në këtë mënyrë biznesi ka fituar besimin tek ofruesit e AFP-ve të cilat kanë kapacitete për të arsimuar nxënë/kursantë, ku tregu i punës në fund ju ka “*dhuruar*” kontrata pune.

b. Dobësitë

Bazuan në raportet që vetë ofruesit e AFP-ve japin del në pah që jo të gjithë ofruesit e AFP-ve kanë të identifikuar qartë dhe saktë bizneset që operojnë në zonat ku jetojnë apo mësojnë nxënësit/kursantët. Jo të gjithë ofruesit e AFP-ve kanë të konsoliduar bashkëpunimin me biznesin dhe mbetet ende detyrë për tu përmbushur nga na e tyre. Ka ende mospërputhje të kurrikulave në nivelin e shkollave. Biznesi ende nuk është i përfshirë në analizën e tregut apo të merën në konsideratë sugjerimet e tyre. Mbetet ende sfidë për ofruesit e AFP-ve të intensifikojnë bashkëpunimin me bizneset e rajonit në mënyrë që të fitojnë edhe besimin e tyre.

3. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe komunitetin

a. Rezultati

Nuk ka një progres të theksuar apo të dukshëm në këtë fushë, ka përpjekje por kanë rezultuar jo të efektshme, kjo për vetë faktin se nëpërgjithësi *prindërit* (që përbëjnë një pjesë të komunitetit) nuk përfshihen në organizmat apo veprimtaritë që ofruesit e AFP-ve zhvillojnë megjithë përpjekjet e saj. Në lidhje me OJF-të, vihet re që disa ofrues të AFP-ve kanë bashkëpunim të frytshëm më to (*OJF*) duke zbatuar projekte në përputhje me qëllimin dhe synimin që ka institucioni, si dhe duke i publikuar në faqet e tyre të internetit.

b. Dobësitë

Mungesa e përfshirjes së prindërve, motivim jo në nivelin e duhur e prindërve që të përfshihen në strukturat apo veprimtaritë e ofruesve të AFP-ve, vështirësitë socialo-ekonomike, mungesa në ambiente apo e materialeve, pa mundësi për ta kthyer në qendër komunitare. Disa ofrues të AFP-ve ende nuk kanë identifikuar OJF-të që operojnë në rajon, si dhe nuk kanë kapacitete për të hartuar projekte zhvillimore.

4. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vet ofruesve të AFP-së dhe institucioneve


a. Rezultati

Ka një zhvillim pozitiv në këtë drejtim sepse vetë ofruesit e AFP-ve janë mëse të qarta dhe të gatshme si dhe kanë dëshirë për të rritur bashkëpunimin në këtë drejtim, vetë ofruesit e AFP-ve që kanë të njëjta kualifikime janë të idenfikuara mes njëri-tjetrit dhe zhvillojnë vizita, shkëmbejnë përvoja, eksperiencia të mira, ruajnë dokumentacionin përkatës të këtyre vizitave, zbatojnë planin vjetor të promovimit të institucionit duke treguar vlerat më të mira dhe të vërteta që institucioni ju ofron nxënësve/kursantëve, me anë të përdorimit të formave nga më të ndryshe të promovimit, zhvillojnë me suksese “ditët e hapura”. Ofruesit e AFP-ve zhvillojnë takime institucionet postsekondare dhe atij të lartë për trajnimin e stafit, përmirësimin e përgatitjes profesionale, i publikon të gjitha këto veprimtari si dhe i dokumenton në mënyrë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

b. Dobësitë


Pengesat kryesore që mund të haset janë mosrealizimi në përmasat e duhura për shkak të pamjaftueshmërisë të fondeve, siç janë “shkëmbime vizitave”, “ditët e hapura”.

Në formë grafike rezultati i fushës për 15 ofrues të AFP-së do të paraqitet si më poshtë⁵.”




⁵ Vlera numerike 1 është shumë mire, kurse vlera numerike 4 është shumë dobët

Në formë grafike rezultati i **nënfushave** të Fushës 2 “*Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi*” do të paraqitet si më poshtë:



Nga analiza e 15 ofruesve të AFP-së të cilët kanë plotësuar fushën 2 “*Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi*” ka rezultuar se 2 prej tyre e shohin veten **shumë të mirë** në këtë fushë, 12 prej tyre e shohin veten të **mirë**, 1 prej tyre e shohin veten **mjaftueshëm**, ndërkohë që nuk ka asnjë ofrues që e ka vlerësuar veten dobët. Të dhënat janë paraqitur në figurën e mëposhtme:



FUSHA 3-Kurrikula e zbatuar

Veprimtaritë e organizuara nga ofruesit e AFP-së në lidhje me kurrikulën e zbatuar kanë për qëllim të pajisin nxënësit me njohuritë, me aftësitë kyçe dhe profesionale, si dhe me sjelljen e duhur për të gjetur një vend pune në tregun e punës.

Duke iu referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, niveleve të kualifikimeve 2-5, kurrikula e ofruesve të AFP-së hartohet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, e ashtuquajtura kurrikula kuadër, ndërsa kurrikula e detajuar dhe e zhvilluar në nivelin e ofruesve të AFP-së, e ashtuquajtura kurrikula shkollë është përgjegjësi e shkollës dhe kryhet në përputhje me kërkesat për kualifikim. Kurrikula është e organizuar në tre kategori kryesore: teori e përgjithshme, teori profesionale dhe praktikë profesionale. Zbatimi i mirë i kurrikulës shërben, ndër të tjera, për të vënë në zbatim njohuritë që nxënësit marrin në shkollë ose qendrat e trajnimit, duke përfshirë zbatimin e teorisë dhe praktikës në vendin e punës. Po ashtu, një kurrikulë e zhvilluar dhe e zbatuar siç duhet shërben për të ngushtuar hendekun ndërmjet ofertës dhe kërkesës, pra ndërmjet asaj që prodhon shkollë në raport me kërkesat e tregut. **(copy paste raporti)**

Analiza e rezultateve dhe dobësive të fushës vijon si më poshtë:

Përmbledhje sipas nënfushave

1. Kurrikula me bazë shkolle të AFP-së

a. Rezultati

Mësuesit dhe instruktorët përdorin dokumentet zyrtare të kurrikulës gjatë procesit të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës në nivel institucioni si për formimin e përgjithshëm edhe për atë profesional. Mësuesit hartojnë dhe zbatojnë plane vjetore lëndore të formatuara dhe të mbështetura në programet lëndore, në dokumentet zyrtare dhe kryesisht bazohen te tekstet që mësuesit për zgjedhin Programet vjetore lëndore kontrollohen dhe miratohen nga drejtori i shkollës, pasi janë hartuar nga ekipet lëndore të mësuesve.

b. Dobësitë

Një problem i theksuar pothuajse të gjithë ofruesit e AFP-së lidhet me tekstet profesionale. Shkollat hasin vështirësi në pajisjen me tekste profesionale ose nuk kanë mundësi që t'i sigurojnë të gjitha tekstet që u duhen sipas kualifikimeve profesionale që ato ofrojnë. Për më tepër, ka edhe raste të raportuara nga ofruesit e AFP-së ku tekstet e lëndëve profesionale mungojnë.

2. Kurrikula në bazë ofruesi të FP-së

a. Rezultati

Është e vështirë të bëhen rezultate përgjithsuese për këtë nënfushë sepse është vetëm një ofrues i FP që ka plotësuar fushën “Kurrikula e zbatuar”. Programet e kurseve të unifikuara që ofrohen janë të zhvilluara konform kërkesave dhe dokumenteve zyrtare. Dokumentet zyrtare të kurrikulës janë të disponueshme dhe veprimtaria mbështetet në këto dokumente. Instruktorët kanë punuar në ekip për hartimin e planeve të mësimdhënies, i gjithë procesi është i miratuar dhe i dokumentuar. DROFPP NR.4 ofron një sërë kursesh jo të unifikuara, përmes programeve të

veçanta dhe harton planet e zhvillimit të këtyre kurseve. Procesi i zhvillimit të kurseve të unifikuara dhe jo të unifikuara është i dokumentuar.

b. Dobësitë

Nevojitet të punohet me më tepër përgjegjësi për sigurimin e teksteve/materialeve mbështetëse për çdo kurs, duke krijuar kështu dhe një literaturë bazë për instruktorët e rinj, por gjithmonë duke e pasuruar me të reja të shkencës. Duhet më tepër punë për të plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe standartet për zhvillimin e kurseve në kabinete.

3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm

a. Rezultati

Plani mësimor në shkollën tonë hartohet në përputhje me planin mësimor të pasqyruar të Skeletkurrikula e Kualifikimeve Profesionale. Programet e mësimdhënies teorike profesionale dhe moduleve të praktikës profesionale zbatohen në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulës së Kualifikimeve Profesionale. Planet 3 mujore ose vjetore lëndore zbatohen nga ana e mësuesve në përputhje me kërkesat zyrtare të dokumenteve kurrikulare. Shkolla ndjek të gjitha procedurat e përzgjedhjes së tekstit të formimit të përgjithshëm, dhe mësuesit janë pjesë e procesit.

b. Dobësitë

Nuk ka dobësi të raportuara nga ofruesit e AFP-së në lidhje me kurrikulën e formimit të përgjithshëm.

4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës

a. Rezultati

Ofruesit e AFP-së përpiqen të zbatojnë përmbajtjen kurrikulare brenda kufirit të autonomisë që u është dhënë.

b. Dobësitë

Pjesa më e madhe e ofruesve të AFP-së kanë nevojë për mbështetje në hartimin dhe zbatimin e përmbajtjes kurrikulare.

5. Ekipi kurrikular


a. Rezultati

Ofruesit e AFP-së e kanë ngritur ekipin kurrikular në shkollë dhe funksionon brenda shkollës, i kryesuar nga drejtori i shkolles, si dhe me pjesëmarrjen e nëndrejtorit, kryetarit të ekipeve lëndore, mësuesve dhe instruktorëve) konform akteve ligjore. Ekipi kurrikular në bashkëpunim me ekipet lëndore luan një rol parësor në hartimin dhe zbatimin e programeve të mësimdhënies.


b. Dobësitë

Ka vetëm një ofrues AFP-je ku ekipi kurrikular nuk ka qenë i ngritur. Vihet re se pavarësisht faktit se ekipi kurrikular funksionon në shkollë, bashkëpunimi midis anëtarëve të ekipit nuk është në nivelin që duhet të jetë dhe duhet më tepër punë nga ekipi kurrikular për nxitjen dhe zbatimin e projekteve lëndore. Konkretisht janë pesë ofrues AFP-je tek të cilët mungon bashkëpunimi, dhe nga këta të pestë një ofrues ka raportuar se në ekipin kurrikular nuk ftohen përfaqësues nga qeveria e nxënësve apo nga këshilli i prindërve.

Në formë grafike rezultati i fushës së do të paraqitet si më poshtë⁶:




Në formë grafike rezultati i **nënfushave** të Fushës “Kurrikula e zbatuar” do të paraqitet si më poshtë:



Nga analiza e 12 ofruesve të AFP-së të cilët kanë plotësuar fushën 3 “Kurrikula e zbatuar” ka rezultuar se 9 prej tyre e shohin veten **shumë të mirë** në këtë fushë, 3 prej tyre e shohin veten **të mirë**, ndërkohë që nuk ka asnjë ofrues që e ka vlerësuar veten mjaftueshëm apo dobët. Të dhënat janë paraqitur në figurën e mëposhtme:

⁶ Vlera numerike 1 është shumë mire, kurse vlera numerike 4 është shumë dobët

Në grafikun e mëposhtëm jepet e detajuar vlera e arritjes nga 12 ofruesit e AFP-së, për secilin tregues të fushës “Kurrikula e zbatuar”. Shohim se treguesi “Kurrikula në bazë shkolle të AFP-së” dhe “Kurrikula në bazë ofruesi të FP-së” janë më afër nivelit “Shumë mirë”, ndërkohë që treguesit e tjerë, “Kurrikula e formimit të përgjithshëm” ;”Mbështetja për zbatimin e kurrikulës” dhe “Ekipi kurrikular i ofruesit të AFP-së janë më afër nivelit “Mirë”, që do të thotë që ka ende çështje që kërkojnë përmirësim



FUSHA 4 –Mësimdhënia dhe të nxënit

Mësimdhënia dhe të nxënit janë dy procese të rëndësishme, të cilat mundësojnë përvetësimin e programeve mësimore të kurrikulës së formimit profesional dhe atij të përgjithshëm nga nxënësit/kursantët, si dhe përmbushin kërkesat e kualifikimeve profesionale të ofruara nga ofruesit e AFP-së. Kjo fushë është mjaft komplekse dhe delikate për t’u vëzhguar, analizuar dhe për t’u vlerësuar. Modelet mësimore që përdoren me nxënësit dhe kursantët, janë të shumta dhe të larmishme.

Vetëvlerësimi në këtë fushë ka për qëllim të identifikojë efikasitetin e proceseve të mësimdhënies dhe të nxënit, procese të cilat mundësojnë përvetësimin e kompetencave profesionale në përputhje me kërkesat e kualifikimit, si dhe të kompetencave të tjera të nevojshme që të diplomuarit në AFP të gjejnë vendin e tyre në botën e punës pas përfundimit me sukses të arsimit profesional.

Duke qenë se mësimdhënia dhe të nxënit është një fushë e gjerë dhe shumë e rëndësishme e arsimit profesional, treguesit dhe kriteret, pra, përshkruesit e treguesve dhe nivelet e vlerësimit, janë të shumtë. Kjo shërben për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor si nga

mësuesi, edhe nga instruktori, duke u bazuar në gjetje dhe përpunime reale të situatës së mësidhënies dhe të të nxënësve në klasa dhe /ose në mjediset reale të punës.

Përmbledhje sipas nënfushave

1. Plani ditor

a. Rezultati

Plani ditor përgatitet rregullisht nga mësuesit dhe nga instruktorët si për lëndët e formimit të përgjithshëm edhe për lëndët profesionale. Hartimi i tij bëhet në përputhje me udhëzimet zyrtare.

b. Dobësitë

Dobësitë në këtë nënfushë lidhen me faktin se plani ditor nuk përshtatet sipas veçorive të nxënësve, si dhe nuk përfshin rezultate të barazisë gjinore.

2. Rezultatet mësimore

a. Rezultati

Metodat, teknikat dhe strategjitë e përdorura sigurojnë arritjen e objektivave/rezultateve mësimore por disa ofrues kanë raportuar se niveli i ulët i nxënësve, nuk mundëson realizimin gjatë orës mësimore të objektivave në të gjitha nivelet e nxënësve. Plani mësimor i zhvilluar mundëson arritjen e objektivave /rezultateve bazë të orës mësimore.

b. Dobësitë

Dobësitë në këtë nënfushë lidhet me faktin se shpeshherë nuk parashikohet koha për çdo veprimtari, kërkesat ku duhet të vlerësohet nxënësi, nuk zbatohet me rigorozitet koha e planifikuar për çdo orë mësimore.

3. Parimet kryesore gjatë orës mësimore

a. Rezultati

Gjatë orës mësimore, mësuesi/instruktori përcakton si parësore përvetësimin nga nxënësit të koncepteve dhe aftësive kryesore të lëndës/modulit dhe zbulimin e lidhjeve mes tyre nëpërmjet përsëritjes së kapitujve, por kjo nuk ndodh te të gjithë ofruesit.

b. Dobësitë

Shpesh, gjatë orëve mësimore, ka vetëm trajtim teorik të temës/çështjes dhe nuk kombinohet me fakte nga jeta e përditshme. Aftësitë ndërkurikulare në shumicën e rasteve nuk janë të mjaftueshme, mësuesit shpesh pasqyrojnë lëndën e tyre pa bërë lidhje me lëndët e tjera.

4. Ana shkencore

a. Rezultati

Mësuesit dhe instruktorët kanë një formim të mirë shkencor, si dhe zotërojnë aftësitë e domosdoshme praktike për zhvillimin e lëndës/modulit.

b. Dobësitë

Ofruesit e AFP-ve kanë raportuar se pavarësisht se mësuesi/instruktori ka një formim të mirë shkencor, ka nevojë për trajnime sidomos për aftësitë dhe konceptet bashkëkohore të lëndëve dhe moduleve profesionale si dhe në mënyrë të veçantë nevojiten trajnime për instruktorët e jashtëm për të rritur cilësinë e mësimdhënies.

5. Baza materiale dhe didaktike

a. Rezultati

Baza materiale dhe didaktike që ekziston aktualisht në shkollë planifikohet dhe përdoret gjatë orëve mësimore, pavarësisht nëse është apo jo në sasinë e duhur për të mbuluar nevojat e të gjithë nxënësve. Për këtë arsye, mësuesit gjatë orëve mësimore përdorin mjete mësimore të krijuara nga vetë ata për të ndihmuar nxënësit në arritjen e objektivave mësimore.

b. Dobësitë

Përgjithësisht baza materiale dhe didaktike nuk është e sigurtar që të mbulojë nevojat e të gjithë nxënësve për të realizuar me efektivitet punët praktike. Nga ana tjetër nevojitet edhe bashkëpunimi i mësuesve dhe instruktorëve me nxënësit, prindërit dhe komunitetin për të siguruar bazën materiale të domosdoshme.

6. Mjedis fizik

a. Rezultati

Mjedi fizik është deri diku i përshtatshëm dhe funksional, është i pajisur me laboratorët e nevojshëm për zbatimin e moduleve të praktikave mësimore, duke përmbushur në këtë mënyrë kriteret bazë për të qenë një institucion arsimor. Një pikë tjetër për tu vlerësuar është se ka edhe shkolla të cilat kanë bërë përpjekje për ta kthyer mjedisin fizik të shkollës në kushte funksionale për të lehtësuar mësimdhënien dhe për të motivuar nxënësit.

b. Dobësitë

Mjedis fizik ka ende nevojë të përmirësohet për të zhvilluar procesin mësimor për shkak të hapësirave të kufizuara për zhvillimin e kurseve sipas kërkesave të standardizuara dhe për shkak të mosplotësimit të kushteve teknike, pavarësisht se ekzistojnë edhe mjediset laboratorike.

7. Metodologjia

a. Rezultati

Metodat, teknikat dhe strategjitë e përdorura duke i përshtatur edhe me nivelin e nxënësve dhe veçoritë e profesionit, sigurojnë arritjen e objektivave/rezultateve mësimore. Gjithashtu përdoren edhe metoda që synojnë të rrisin bashkëpunimin midis kursantëve në detyrat praktike që zhvillohen në klasë. Në përgjithësi shpjegimet, demonstrimet e instruktorëve janë të qarta dhe të kuptueshme dhe gjithashtu jepet feedback në çdo orë mësimore.

b. Dobësitë

Jo gjithmonë mësuesi synon të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat profesionale. Kjo, sipas raportimeve, mund të vijë edhe si pasojë edhe e nivelit jo të lartë të nxënësve, pasi nxënësit me vështirësi bëjnë gjykime dhe ofrojnë zgjidhje. Duke qenë se viti 2019-2020, ishte viti i pandemisë, kjo e bëri të vështirë stimulimin e nxënësve për të marrë pjesë në mësimdhënien online. Ajo që dallohet në qendrat e formimit profesional është se shpjegimet e instruktorëve shpesh kërkojnë qartësime të mëtejshme dhe jo të gjithë instruktorët dhe kursantët në fund të orës mësimore japin një ‘feedback’ për shkallën e arritjes së objektivave mësimore/rezultateve të vendosura. Gjithashtu në këto qendra nuk përdoren metoda dhe teknika të shumëllojshme gjatë orës mësimore.

8. Detyrat e shtëpisë

a. Rezultati

Në lidhje me rezultatin e kësaj nënfushe, janë shumë pak ofrues të AFP-ve, (është e vështirë për tu përgjithësuar), të cilët i planifikojnë dhe i japin nxënësve detyra shtëpie duke i sqaruar ato në fund të mësimit.

b. Dobësitë

Nga analiza e kësaj nënfushe rezulton se përgjithsisht mësuesit nuk japin detyra shtëpie nxënësve ose detyrat e shtëpisë jepen shumë rrallë. Një dobësi tjetër është se edhe kur detyrat e shtëpisë jepen, nuk shënohen në ditarin e mësuesit dhe nuk përshtaten me nivele vështirësie. Kjo do të thotë që nxënësit nuk nxiten për të vijuar të nxënit edhe në shtëpi.

9. Përsëritja

a. Rezultati

Është një nënfushë të cilën 3 ofrues AFP-je kanë raportuar se orët e përsëritjes teorike dhe praktike planifikohen dhe zhvillohen nga mësuesi/instruktori.

b. Dobësitë

Vihet re që përsëritja nuk realizohet nga pjesa më e madhe e mësuesve në ofruesit e AFP-së. Edhe tek ofruesit që praktikohet përsëritja, mësuesi nuk i angazhon nxënësit në zbulimin e lidhjeve të koncepteve të kapitullit/temës me ato të lëndëve të tjera. Duke qenë se përsëritja nuk praktikohet tek shumica e ofruesve nuk kemi mundësi që të bëjmë analiza më të thella për këtë nënfushë të tilla si; realizimin e përsëritjes në mënyrë të pavarur apo të organizuar në grupe, apo përdorimin e metodave të larmishme për një përsëritje cilësore.

10. Mjedis i sigurt për të nxënësit

a. Rezultati

Kjo nënfushë ka arritje pozitive. Në një masë të madhe ofruesish AFP-je, nxënësit ndihen të lirshëm për të shprehur idetë, mendimet dhe zgjidhjet e tyre. Të gjithë kursantët/nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, gjë që del në pah gjatë monitorimeve të orëve mësimore dhe pyetësorëve të realizuar. Mbizotëron një klimë pozitive në klasë dhe në mjedisin e praktikës e cila nxit bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen aktive të kursantëve në procesin e të nxënësit. Përsa i përket rasteve të konflikteve, dhunës dhe bullizmit, ato menaxhohen nga këshilli i disiplinës.

b. Dobësitë

Nuk ka dobësi të raportuara nga ofruesit e AFP-së përsa i përket mjedisit të sigurt për të nxënësit.

11. Nxënësit/kursantët me nevoja të veçanta


a. Rezultati

Mësuesit bëjnë përpjekje për tu ofruar ndihmë dhe mbështetje nxënësve/kursantëve me nevoja të veçanta, për të siguruar përfshirjen e tyre gjatë orëve mësimore si dhe për t'i integruar ata në detyra praktike të përbashkëta.


b. Dobësitë

Shumë pak janë ofruesit që bëjnë përpjekje për të identifikuar nxënësit me nevoja të veçanta ose me vështirësi në të nxënë. Pavarësisht përpjekjeve të mësuesve, nuk zbatohen plane edukative të personalizuara, (planet PEI), për nxënësit/kursantët me nevoja të veçanta në rastet kur këta nxënës janë të identifikuar.

Në formë grafike rezultati i fushës për 10 ofures të AFP-ve do të paraqitet si më poshtë⁷:




Në formë grafike rezultati i **nënfushave** të Fushës “Mësimdhënia dhe të nxënit” do të paraqitet si më poshtë:



Nga analiza e 10 ofruesve të AFP-së të cilët kanë plotësuar fushën 4 “Mësimdhënia dhe të nxënit” ka rezultuar se 2 prej tyre e shohin veten **shumë të mirë** në këtë fushë, 7 prej tyre e shohin veten të **mirë**, 1 prej tyre e shohin veten **mjaftueshëm**, ndërkohë që nuk ka asnjë ofrues që e ka vlerësuar veten dobët. Të dhënat janë paraqitur në figurën e mëposhtme:

Nga grafiku i mëposhtëm shihet se treguesi “Mjedisi i sigurt për të nxënit”, është më afër nivelit “Shumë mirë”, ndërkohë që të gjithë treguesit e tjerë të kësaj fushe janë më afër nivelit “Mirë”. Pra, ka ende çështje që kërkojnë vëmendjen e duhur për t’u përmirësuar në të ardhmen

⁷ Vlera numerike 1 është shumë mire, kurse vlera numerike 4 është shumë dobët



FUSHA 5 – Vlerësimi

Në vetvete *Fusha 5* ka për qëllim kryesor gjykimin e mësuesit/instruktorit mbi arritjet e nxënësit/kursantit për kurrikulën e përvetësuar. Nuk duhet të harrojmë që vlerësimi mbështetet në parime që e bëjnë atë të jetë një veprimtari e planifikuar, e vazhdueshme dhe pjesë integrale e praktikave më të mira të procesit të mësimdhënies dhe të nxënies.

Janë **21** ofruesit të AFP-ve të cilat kanë kryer vetëvlerësimin në fushën e pestë në “*Vlerësimin*”. Kjo fushë përbëhet nga gjashtë nënfusha:

1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit
2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit
3. Procesi i vlerësimit
4. Arritjet
5. Rivlerësimi
6. Ankimimet

1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit

a. Rezultati

Ofruesit e AFP-ve kryejnë me rregullsi direktivat e nënfushës së vlerësimit periodik, tashmë mund të pohojmë se ky veprim është bërë pjesë integrale e veprimtarisë së shkollës dhe të vetë mësuesit/instruktorit të cilët kryejnë vlerësime periodike

b. Dobësitë

Vihet re nga raportimet e vetë ofruesit e AFP-ve që ka një mosfunksionim në nivelin e duhur të “*vetëvlerësimit të nxënësit*” apo edhe të “*vlerësimit të nxënësve nga nxënësit*”.

2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit

a. Rezultati

Është një proces që mësuesit/instruktorët e kryejnë rregullisht si dhe vetë drejtorja e ofruesve të AFP-së e ndjek me vëmendje këtë proces. Mësuesit/instruktorët kryejnë vlerësimin përfundimtar, përshkruajnë nivelin e arritjes, argumenton kompetencën e nxënësit për fushën; lëndën e studimit, mësuesi respekton peshën e përqindjeve zyrtare të vlerësimeve, mësuesi/instruktori njehëson notën përfundimtare, mësuesi/instruktori përfshin në programin e vlerësimit përdorimin e instrumenteve të ndryshme të vlerësimit.

b. Dobësitë

Bazuar nga raportet ofruesit e AFP-ve kanë hasur vështirësi për të përmbushur këtë pikë për shkak të se mësuesi jo gjithmonë kanë përdorur një program vlerësimi përfundimtar me objektiva apo rezultate të përcaktuara, si dhe nuk kanë përdorur gjërësisht evidencat për pasqyrimin e vlerësimeve të nxënësve.

3. Procesi i vlerësimit

a. Rezultati

Nga raportimet që ofruesit e AFP-ve kanë depozituar si dhe nga vizitat e monitorimit që AKAFPK-ja ka kryer shihet që mësuesit/instruktorët është aktiv në kryerjen e procesit të vlerësimit. Mësuesi/instruktori kanë programe të qarta dhe të plota për vlerësimin e nxënësit/kursantit, përdor instrumentat të ndryshme të vlerësimit, mban evidenca për vlerësimin, përdorin të dhënat e papërpunura. Mësuesi/instruktori kryen vlerësime motivuese, të paanëshme, vlerësime përmbledhëse, vlerësim për të diagnostikuar njohuritë e nxënësve,

b. Dobësitë

Nga verifikimet e AKAFPK-së, disa ofrues të AFP-ve ende shfaqin dobësi në lidhje me vlerësimin e nxënësve ku mësuesit/instruktorët nuk përdorin gjërësisht evidencat për pasqyrimin e vlerësimeve të nxënësve, apo mësuesit/instruktorët bëjnë një vlerësim në bazë të objektivave por jo gjithmonë duke u bazuar në një program të qartë dhe të shkruar, ose shikohet që mësuesi/instruktori nuk e ka të dokumentuar vlerësim formues që kryen me nxënësin me qëllim motivimin e tij, apo jo gjithmonë mësuesi përdor teknika vlerësimi ku nxënësit vlerësojnë veten dhe njëri-tjetrin.

Është evidentuar që ka prindërit që nuk janë të qartë për programin e vlerësimit. Dokumentimi i veprimtarisë të mësuesve/instruktorëve mbetet ende një detyrë për tu përmbushur dhe për tu përmirësuar.

4. Arritjet

a. Rezultati

Ofruesit e AFP-ve kryejnë analizën e rezultateve të nxënësve si dhe analizat përkatëse të provimeve të maturës shtetërore, kryhen krahasimet e të vlerësimeve të bëra nga ofrues të AFP-ve me vlerësimin e jashtëm të provimeve të maturës shtetërore. Kryhen analiza e rezultateve të nxënësve në provimin e teorisë profesionale të integruara, analizohen rezultatet e kursantëve në provimin përkatës të kurseve të unifikuara. Vihet re një zbatim i udhëzimit përkatës për procesin e zhvillimit të provimeve përfundimtare. Mësuesit informojnë prindërit për rezultatet e nxënësve.

b. Dobësitë

Mbetet ende punë për përmbushja nga ofruesit e AFP-ve, ka mangësi në lidhje me arritjet. Një arsye kryesore është që nxënësit që vijnë nga sistemi 9-të vjeçar në ofruesit e AFP-ve janë me mangësi të theksuara njohure, e cila e pengon të ndjekë ritmin e të nxënurit normal si dhe krijon një vështirësi në mësim-nxënien për shkak të vështirësive në përthithjen e njohurive nga vetë nxënësit e rinj të sapo ardhur. Vihet re edhe një vështirësi në bashkëpunimin me prindërit për arsye të ndryshme (*interes i ulët, distancat shtëpi-shkollë, pamundësi relale për ta ndjekur etj*).

5. Rivlerësimi

a. Rezultati

Është një nënfushë që ofruesit e AFP-ve e realizojnë dhe ju japin mundësi nxënësve apo kursantëve për të kryer rivlerësime në përputhje të plotë me kuadrin ligjor.

b. Dobësitë

Nuk janë hasur dobësi në këtë drejtim

6. Ankimimet


a. Rezultati

Edhe në këtë nënfushë ofruesit e AFP-ve kanë arritur të përmbushin detyrimin ligjor, procedurat janë të qarta, standarte si dhe çdo përgjigje kryhet brenda afateve të parashikuara duke marrë në konsideratë çdo ankese që adresohet.


b. Dobësitë

Nuk janë evidentuar dobësi.

Në formë grafike rezultati i fushës së pestë për 21 ofrues të AFP-së do të paraqitet si më poshtë⁸.




Në formë grafike rezultati i **nënfushave** të Fushës “Vlerësimi” do të paraqitet si më poshtë:



Nga analiza e 21 ofruesve të AFP-së të cilët kanë plotësuar fushën 5 “Vlerësimi” ka rezultuar se 7 prej tyre e shohin veten **shumë të mirë** në këtë fushë, 14 prej tyre e shohin veten të **mirë**, ndërkohë që nuk ka asnjë ofrues që e ka vlerësuar veten mjaftueshëm apo dobët. Të dhënat janë paraqitur në figurën e mëposhtme:

⁸ Vlera numerike 1 është shumë mire, kurse vlera numerike 4 është shumë dobët.



KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUSIONE

Procesi i vetëvlerësimit u shërbeu kryesisht të gjithë ofruesve të AFP-së për të vlerësuar gjendjen dhe performancën e institucionit, funksionimin e organizmave dhe mënyrat e veprimit brenda institucioneve të tyre në lidhje me dimensionet e cilësisë kryesisht në mësimdhënie, të nxënësve dhe kualifikimin e nxënësve. Ofruesit e AFP-ve për shkak të përdorimit të instrumentit të vetëvlerësimit janë në gjendje të identifikojnë lehtësisht pikat e dobëta si dhe të vendosin të ndërtojnë plane për të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbutjen/eliminimi e këtyre dobësive.

Është mëse e kuptueshme që sa më objektivisht të kryhet procesi i vetëvlerësimit, aq më mirë identifikohen arritjet, si dhe problematikat që ofruesit e AFP-së. Në të vërtetë, të gjitha institucionet pjesëmarrëse kanë identifikuar përmes këtij procesi aspektet e tyre pozitive, si dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim. Ky është një rezultat i rëndësishëm dhe shumë i dobishëm për ofruesit e AFP-së.

AKAFPK-ja ka patur një rol tepër aktiv në udhëzimet dhe trajnime të stafe-ve apo të personave që ndjekin ecurinë e procesit të vetëvlerësimit, si dhe vihet re që të gjithë ofruesit e AFP e kanë vlerësuar si proces dhe besojnë në rezultati që vetëvlerësimi jep. Ofruesit e AFP-ve e shohin vetëvlerësimin si një instrument efektiv dhe janë përkushtuar për ta përdorur sa më mire duke përfshirë të gjithë struktura e tyre të brendshme.


Në përgjithësi procesi u zbatua mirë dhe në përputhje me urdhrin e ministrit nr.16/1, datë 17.10.2018 “*Për zhvillimin e procesit të vetëvlerësimit*”, vihet re se Ofruesit e AFP-ve kanë intensifikuar ndërveprimin e strukturave të tyre brendshme.

Raportet e marra nga 44 ofruesit janë një burim informacioni i mirë në vetvete ku do të rendimit gjetjet kryesore, duke nisur kryesisht me vlerësimet pozitive dhe më pas duke vënë në dukje

sfidat që do të duhet të adresohen nga ana e ofruesve të AFP-së në të ardhmen për tu përmirësuar.

Raportet në përgjithësi karakterizohen nga një gjuhë standarde që rrjedh nga terminologjia e instrumentit të vetëvlerësimit, por ende është e dukshme që në formulimet e fjalive nuk janë profesionale, ose terminologjia që përdoret nuk është e duhura. Përgjithsisht nuk ka një analizë të thelluar që do të ndihmonte në artikullimin e gjetjeve dhe konkluzioneve më specifike.

Nga ana grafike vetëvlerësimi në nivel kombëtar do të shfaqej si më poshtë:



Raportet përmblendhëse theksuan disa aspekte pozitive dhe negative si më poshtë vijon:

Aspektet pozitive

- Procesi i vetëvlerësimit i ndihmoi ofruesit e AFP-së të kuptojnë nevojën për standardizimin e procesit dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni, të ritjes së intensitetit të bashkëpunimit ndërmjet vetë strukurave që ka ofruesi i AFP-së, të harmonizuara me dokumentimin e proceseve, hartimin e dokumentave dhe evidencave që përdoren dhe shfrytëzohen brenda institucionit;
- Përmes procesit të vetëvlerësimit, ofruesit e AFP-së mundën të identifikonin pikat e tyre të forta dhe të dobëta, si mungesa e përdorimit të mjeteve dhe instrumenteve që përdorin institucionet për të zyrtarizuar të gjithë procesin dhe veprimtaritë e zhvilluara nga institucionet e AFP-së. Instrumenti i vetëvlerësimit përfshiu modele dhe instrumenta të tjera për t'i ndihmuar ata të kuptojnë se proceset duhet të dokumentohen/zyrtarizohen me dokumentet përkatëse, të tilla si formularë, marrëveshje etj., përdorimi i të cilave ndihmon në menaxhimin e proceseve brenda institucionit dhe nxënësit në procesin e të nxënës. Në rastin e vetëvlerësimit, ai shërben gjithashtu për të verifikuar dhe dokumentuar kriteret e përcaktuara në udhëzuesin instruktiv;

- Vetëvlerësimi shërbeu gjithashtu që ofruesi i AFP-së të vlerësojë veten në mënyrë më objektive, si dhe të ndërmarë hapa për të ndërtuar një plan në të ardhmen ku të ndjekë rekomandimet e nxjerra dhe të deklaruar nga vetë ofruesi i AFP-së.

Aspektet që duhen përmirësuar

- Kryesisht Ofruesit e AFP-ve kanë mungesë të theksuar në cilësinë e raporteve vjetore të vetëvlerësimit.
- Vërehet që ka një paqartësi të plotësimit të raporti të vetëvlerësimit dhe mungesë orientimi.
- Mangësi nga ana e plotësimit formal të raportit të vetëvlerësimit, organizimi i informacionit në një mënyrë të duhur sikundërse urdhërohet në *shtojca 3* paraqet në *Udhëzimin nr. 16/2018 (i ndryshuar)*.
- Ka një bashkëveprim të dobët me donatorë të ndryshëm për përthithjen e fondeve.
- Mungesa në kapacitet për të qasur thirrje të ndryshme të grandeve që jepen nga donatorë ndërkombëtarë.
- Në disa ofrues të AFP-ve përballen më mbi ngarkesë të orëve të mësimi për mësues/staf të cilat janë të përfshirë në procesin e vetëvlerësimit.
- Kontingjenti i nxënësve/kursantëve janë me mungesa të theksuara të njohurive dhe dijeve (nga sistemi 9-të vjeçar).
- Prindërit nuk përfshihen në nivelin e duhur në aktivitetet apo strukturat e ofruesit të AFP-ve.
- Baza materiale mbetet sërisht në nivel jo të plotë duke krijuar mungesa në praktikat e punës aq të nevojshme për formimin e nxënësve/kursantëve.
- Ofruesit e AFP-ve duhet të vazhdojnë të shtojnë përpjekjet (edhe në bashkëpunim me institucionet zyrtare) për të rritur bashkëpunimin me sektorin privat duke i shkëmbyer dijet, praktikat, përvojat më të fundit me qëllim që bizneset lokale/rajonale të rritin besimin tek Ofruesit e AFP-ve duke ndikuar direkt edhe tek punësimi i plotë/sezonal i nxënësve/kursantëve.
- Roli Bordit dhe i këshillave nuk është shumë aktiv në adresimin e sfidave që ofruesit e AFP-ve hasen.
- Mungesë në dokumentimin e aktiviteteve dhe veprimtarive të ofruesve të AFP-ve të cilat kryhen por jo gjithmonë dokumentohen.
- Në përgjithësi, institucionet e AFP-së nuk kanë ndonjë instrument për identifikimin e nevojave për trajnim të stafit pedagogjik.
- Nga analiza e ofruesve të AFP-së, marrja në konsideratë dhe zbatimi i aspekteve gjinore nuk vërehet të zbatohet tek ofruesit e AFP-së. Vetëm pak raste të ofruesve të AFP-së kanë raportuar se tematikat që kanë në fokus barazinë gjinore janë të përfshira në planin mësimor. Ka ende nevojë të punohet për trajtimin e theksimit të dallimeve gjinore.
- Shkollat kanë nevojë për mbështetje në hartimin dhe zbatimin e përmbajtjes kurrikulare.

- Shkollat duhet t'i kushtojnë rendësi përveç planeve mësimore, edhe planit të praktikave profesionale duke gjetur rrugët e përshtshme për sigurimin e kryerjes së praktikave profesionale nga të gjithë nxënësit/kursantët.
- Duke qenë se tekstet profesionale mungojnë ose është e vështirë për t'i gjetur ato, është e rëndësishme të merren masa për të përmirësuar gjendjen e teksteve profesionale si dhe për të mundësuar hartimin e tyre në rastet kur ka mungesa.

REKOMANDIME

1. Rritja e kapaciteteve të njësive të zhvillimit të ofruesve të AFP-ve në lidhje me përpilimin më cilësor të raporteve, përdorimin sa më mirë të metodave për të identifikuar sfidat/vështirësitë/problemët që ofruesit e AFP-ve hasin.
2. Ndërtimin e një strategjie më të qartë dhe të arritshëm në lidhje me përfshirjen e prindërve në strukturat apo aktivitetet e ofruesve të AFP-ve.
3. Të përfshihen më shumë bordet e ofruesive të AFP-ve; institucionet vendore me qëllim të përthithjes së fondeve nga buxhetet vendore qeverisëse.
4. Duke u bazuar në rezultatet e zbatimit të vetëvlerësimit ofruesver të AFP-së duhet t'i ofrohet mbështetje dhe monitorim i vazhdueshëm për të zbatuar me rigorozitet zbatimin e vetëvlerësimit në përputhje me kalendarin e hartuar nga AKAFPK.
5. Identifikimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, me nevoja të veçanta dhe me vështirësi në të nxënë si dhe hartimin dhe zbatimin e planeve individuale për ta (planet PEI).
6. Mbështetjen me materiale mësimore për nxënësit më aftësi të kufizuar, me nevoja të veçanta dhe me vështirësi në të nxënë
7. Institucionet përgjegjëse në nivel qendror (MFE, AKAFPK, AKPA) duhet tu sigurojnë mbështetje ofruesve të AFP-së, në lidhje me:
 - Pajisjen në mënyrë të mjaftueshme të shkollave me laboratorë si dhe me bazën materiale të nevojshme për realizimin e punëve praktike nëpërmjet rritjes së investimeve.
 - Harimtin dhe zbatimin e programeve të trajnimit dhe zhvillimit profesional të stafit mësimdhënës, pasi këto programe nuk u shërbejnë vetëm mësuesve por gjithashtu edhe zhvillimit sa më cilësor të mësimdhënies ku në mënyrë të drejtëpërdrejtë përfitojnë edhe nxënësit. Mësuesit e kualifikuar dhe të trajnuar ofrojnë metoda më të larmishme për të nxënë, dhe i ndihmojnë nxënësit për të zhvilluar aftësi ndërkurrikulare dhe kompetencat kyçe. Në mënyrë të veçantë duhet ti kushtohet vëmendja e duhur trajnimit të mësuesve dhe instruktorëve të jashtëm.